



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-6795/26  
Kaçanik, 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 6 pika 2 shkronja (f) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të nenit 4 paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 52/08 maj 2009), **pas pranimit të aktit të vlerësimit nga ana e MAPL-së** me nr.VI-020-167/5 (MAPL) të dt. 19.03.2026 për Rishqyrtim të ligjshmërisë, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2026, merr këtë:

**VENDIM**  
**PËR NDYRSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01NR.104/02-4631/26**  
**PËR SHPALLJEN NË INTERES PUBLIK TË PARCELAVE**  
**KADASTRALE NË Z.K KAÇANIK DHE Z.K BOB**

1. Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi 01Nr.104/02-4631/26 i dt. 26.02.2026 për shpallje të parcelave me interes publik të pronës së paluajtshme në Z.K KAÇANIK dhe Z.K. BOB, me pronësi të personit Juridik dhe fizik.
2. **MIRATOHET** Propozimi i Kryetarit të komunës së Kaçanikut për shpalljen e interesit publik të ngastrave kadastrale, të identifikuar si:
  - 2.1 Parcela Kadastrale P-70917048-**01988-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=4297 m<sup>2</sup>, në pronësi JLG HOME SH.P.K, me numër të biznesit 812318352, me vendndodhje Rr. "Qamil Ilazi" Z.K Kaçanik të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 1276 m<sup>2</sup>, e cila nevojitet për zgjerimin – Rregullimin e Rrugës "Qamil Ilazi" dhe një pjese të rrugës "Ismajl Qemajli", Z.K Kaçanik.
  - 2.2 Parcela Kadastrale P-70917048-**00568-1**, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=4600 m<sup>2</sup>, në pronësi NEW LEPENCI SH.P.K (Qirambjatje-99 vite), Qiramarrje Castle CITY L.L.C. me numër të biznesit 811556268, me vendndodhje Rr. "Ylli" Z.K Kaçanik të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 680.25 m<sup>2</sup>, e cila nevojitet për zgjerimin – Rregullimin e Rrugës "Ylli" përgjatë lumit Lepenc, Z.K Kaçanik.
  - 2.3 Parcela Kadastrale P-70917008-**00150-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=2694 m<sup>2</sup>, në pronësi BANKA PËR BIZNES, me numër të biznesit 70062470, me vendndodhje Rr. "Vëllezërit Çaka" Z.K Bob të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 230 m<sup>2</sup>, e cila nevojitet për zgjerimin – Rregullimin e Rrugës "Vëllezërit Çaka", gjegjësit trotuarit të rrugës, Z.K Bob.

- 2.4 Parcela Kadastrale P-70917008-00149-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=5011 m<sup>2</sup>, në pronësi BANKA PËR BIZNES, me numër të biznesit 70062470, me vendndodhje Rr. “Vëllezërit Çaka” Z.K Bob të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 159 m<sup>2</sup>, e cila nevojitet për zgjerimin – Rregullimin e Rrugës “Vëllezërit Çaka”, gjegjësisht trotuarit të rrugës, Z.K Bob.
- 2.5 Parcela Kadastrale P-70917008-00741-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=1860 m<sup>2</sup>, në pronësi Tahir (Izahir) Çaka, me vendndodhje Rr. “Vëllezërit Çaka” Z.K Bob të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 224 m<sup>2</sup>, e cila nevojitet për krijimin e një rruge të re për të mirën e përgjithshme për komunitetin e fshatit Bob, Z.K Bob.
- 2.6 Parcela Kadastrale P-70917008-00249-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=31234 m<sup>2</sup>, në pronësi NEW LEPENCI SH.P.K (Qirambjatje-99 vite), Qiramarrje Castle CITY L.L.C. me numër të biznesit 811556268, me vendndodhje Rr. “Ylli” Z.K Bob të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 920.46 m<sup>2</sup>, e cila nevojitet për zgjerimin – Rregullimin e Rrugës “Ylli”, si dhe për të krijuar qasje për tek Bunari-pusi në pronësi të Komunës së Kaçanikut përgjatë lumit Lepenc, Z.K Bob.
- 2.7 Parcela Kadastrale P-70917008-00245-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=575 m<sup>2</sup>, në pronësi NEW LEPENCI SH.P.K (Qirambjatje-99 vite), Qiramarrje Castle CITY L.L.C. me numër të biznesit 811556268, me vendndodhje Rr. “Ylli” Z.K Bob të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 575 m<sup>2</sup>, e cila nevojitet për zgjerimin – Rregullimin e Rrugës “Ylli”, si dhe për të krijuar qasje për tek Bunari-pusi në pronësi të Komunës së Kaçanikut përgjatë lumit Lepenc, Z.K Bob.
3. **Shpallja** e interesit publik të pronave të cekura sipas pikës 2. të këtij vendimi bëhen me qëllim që këto prona të kalojnë në pronësi të komunës së Kaçanikut, pas një procedure të shpronësimit, për realizimin e interesit publik, përkatësisht ndërtimin e rrugës së re fshatin Bob, ndërtimin e rrugës që lidh fshatin Bob me qytetin e Kaçanikut, ndërtimin e rrugës për qasje tek burimi i ujit të pijshëm i quajtur “bunari/pusi” i cili shfrytëzohet për furnizim me ujë të qytetit të Kaçanikut, shpronësimin e pjesës së trotuarit përgjatë rrugës ekzistuese në fshatin Bob, zgjerimi i rrugëve “Qamil Ilazi” dhe “Ismail Qemajli” në Kaçanik.
4. Prona e shpallur për interes publik sipas këtij vendimi do të shërbej ekskluzivisht për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i komunës përmes Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, respektivisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** MAPL; Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni

*Selajdin Troni*



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Data	04.05.2026	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Numri	
		Shtojcë	
01-104/02-10178/26			

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Mëla Org. Org. Jedinca Org. Unit	02	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	1810-2/26
Nr. i faqeve Broj. strana No. pages	-02-	Data. Datum: Date:	30.04.2026
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH
Nga:	Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH Florije Kaka, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH VL 54/26 Prishtinë Datë: 15.04.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e 2. Zyrtari hartues i Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimit 01Nr.104/02-6795/26 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01Nr.104/02-4631/26 për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në ZK Kacanik dhe në ZK Bob

I nderuar kryetar Vishi,  
I nderuar kryesues Troni

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 08.04.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01Nr.104/02-6795/26 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01Nr.104/02-4631/26 për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në ZK Kacanik dhe në ZK Bob

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave konstatoi se:

Prona e shpallur me interes publik sipas Vendimit 01Nr.104/02-6795/26 miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut është pronë private.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-205, Komuna ka të drejtë të realizojë shpronësimin e pronave private brenda territorit të saj për zbatimin e projekteve në interes publik, të planifikuara sipas dokumenteve përkatëse. Rrjedhimisht, Komuna është vetë organi shpronësues.

Në rastin konkret, procedura e shpronësimit duhet të zhvillohet nga Kryetari i Komunës, ndërsa Departamenti i Shpronësimit nuk ka obligime në këtë procedurë dhe nuk duhet të përmendet në asnjë pjesë të vendimit. Procedura duhet të zhvillohet në përputhje me nenin 4, paragrafi 2 të ligjit përkatës, ndërsa nxjerrja e vendimeve duhet të bëhet në përputhje me nenet 8, 10 dhe 11 të po këtij ligji.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejme lidhur me këtë vlerësim.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-4631/26  
Kaçanik, 26.02.2026

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (l) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 4 paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 52/08 maj 2009), të neni 6.2 (f) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01Nr. 104/02-4631/26 nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të datës 19.02.2026, Kuvendi i Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 26 shkurt 2026, mori këtë:

#### VENDIM

### PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELAVE KADASTRALE NË Z.K KAÇANIK DHE Z.K BOB

1. Me këtë Vendim, **SHPALLEN** me interes publik parcelat e pronës së paluajtshme në Z.K KAÇANIK, me pronësi të personit Juridik
2. Sipas pikës 1. të këtij vendimi, shpallen me interes publik parcelat e pronës si vijon:
  - 2.1 Parcela Kadastrale P-70917048-01988-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S= 4297 m^2$ , në pronësi JLG HOME SH.P.K, me numër të biznesit 812318352, me vendndodhje Rr "Qamil Ilazi", ZK Kaçanik, shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe  $1276 m^2$ , e cila nevojitet për zgjerimin - rregullimin e Rrugës "Qamil Ilazi" dhe një pjesë të rrugës "Ismail Qemali", ZK Kaçanik;
  - 2.2 Parcela Kadastrale P-70917048-00568-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S= 4600 m^2$ , në pronësi NEW LEPENCI-2 sh.p.k.(Qirambajtje-99 vite), Qiramarrje Castle CITY L.L.C. me numër të biznesit 811556268, me vendndodhje Rr "Ylli", ZK Kaçanik të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe  $680.25 m^2$ , e cila nevojitet për zgjerimin - rregullimin e Rrugës "Ylli" për gjatë lumit Lepenc, ZK Kaçanik.
3. Me këtë Vendim, **SHPALLEN** me interes publik parcelat e pronës së paluajtshme në Z.K BOB, me pronësi private të personit Juridik – Fizik.
4. Sipas pikës 3. të këtij vendimi, shpallen me interes publik parcelat e pronës si vijon:
  - 4.1 Parcela Kadastrale P-70917008-00150-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S= 2694 m^2$ , në pronësi BANKA PËR BIZNES, me numër të biznesit 70062470, me vendndodhje Rr "Vëllezërit Çaka", ZK Bob, shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe  $230 m^2$ , e cila nevojitet për zgjerimin - rregullimin e Rrugës "Vëllezërit Çaka" ZK Bob;

- 4.2 Parcela Kadastrale P-70917008-00149-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S = 5011 m^2$ , në pronësi BANKA PËR BIZNES, me numër të biznesit 70062470, me vendndodhje Rr "Vëllezërit Çaka", ZK Bob, shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe  $159 m^2$ , e cila nevojitet për krijimin e një rruge të re për të mirën e përgjithshme për komunitet të fshatit Bob, ZK Bob;
- 4.3 Parcela Kadastrale P-70917008-00741-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S = 1816 m^2$ , në pronësi Tahir (Izahir) Çaka, me vendndodhje Rr "Vëllezërit Çaka", ZK Bob, shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe  $224 m^2$ , e cila nevojitet për krijimin e një rruge të re për të mirën e përgjithshme për komunitet të fshatit Bob, ZK Bob;
- 4.4 Parcela Kadastrale P-70917008-00249-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S = 31234 m^2$ , në pronësi NEW LEPENCI-2 sh.p.k.(Qirambajtje-99 vite), Qiramarrije Castle CITY L.L.C. me numër të biznesit 811556268, me vendndodhje Rr "Ylli", ZK Bob, shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe  $920.46 m^2$ , e cila nevojitet për krijimin e një rruge të re për të mirën e përgjithshme për komunitet të fshatit Bob, ZK Bob;
- 4.5 Parcela Kadastrale P-70917008-00245-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S = 575 m^2$ , në pronësi NEW LEPENCI-2 sh.p.k.(Qirambajtje-99 vite), Qiramarrije Castle CITY L.L.C. me numër të biznesit 811556268, me vendndodhje Rr "Ylli", ZK Bob shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe  $575 m^2$ , e cila nevojitet për krijimin e një rruge të re për të mirën e përgjithshme për komunitet të fshatit Bob, ZK Bob.
5. Shpallja e parcelave me interes publik të pronës së paluajtshme në Z.K Kaçanik, Z.K Bob, me pronësi private të personit Juridik dhe Fizik u propozua me qëllim që të krijohet mundësi për zgjerimin dhe rregullimin e rrugëve, për banorët e f. Bob, si dhe për zgjerimin e rrugës "Qamil Ilazi" ZK Kaçanik.
6. Komuna e Kaçanikut nuk do të marrë barrë financiare, mirëpo për pjesët e propozuara me interes për Komunën, do të ju epët në formë honusi, në rast të kërimit të lejes ndërtimore në këto parcela.
7. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, respektivisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
8. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**Me këtë Vendim njoftohen:** MAPL; Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.

